



Kingdom of the Netherlands



DOKUMENT POLITIKASH

Pastrimi i Parave në Kontekstin e Amnitisë Fiskale dhe Penale

Korrik 2022

Dokumenti është hartuar nga AIS në kuadër të projektit C1-EU-NPA



Dokumenti i Politikave me titull “Pastrimi i Parave në Kontekstin e Amnitisë Fiskale dhe Penale” është hartuar nga organizata Albanian Institute of Science AIS / Open Data Albania, në zbatim të projektit C1 – EU – NPA “*Përmirësimi i Debatit mbi Politikat dhe Llogaridhënien për të Përbushur të Drejtat Bazike*”, përmes krijimit të Platformës së Negociatave të Cluster1 Shqipëri. Ky Dokument ka synim të prezantojë analizën e aspekteve kryesore që lidhen me Iniciativën Ligjore për Amnisti Fiskale dhe Penale të Subjekteve që Bëjnë Deklarim Vullnetar të Pasurive, iniciativë e prezantuar si draft ligj për konsultim Publik në datën 23 qershor 2022.

Projekti C1 – EU – NPA zbatohet nga katër organizata shqiptare: Center for the Study of Democracy and Governance CSDG, Instituti i Studimeve Politike ISP, Komiteti Shqiptar i Helsinkit KSHH_dhe Albanian Institute of Science AIS, me mbështetje të Ambasadës së Mbretërisë së Hollandës në Tiranë.

Dokumenti prezantohet si pjesë e iniciativave të shoqërisë civile, që synojnë të japin kontributin e tyre në integrimin europian të vendit.

Gjetjet, Opinionet apo Rekomandimet e shprehura në këtë event përfaqësojnë këndvështrime të ekspertëve dhe organizatës AIS dhe nuk përkojnë me përgjegjësi të partnerëve apo mbështetësve të Projektit C1-EU-NPA.



Metodologjia për hartimin e dokumentit

Metodologjia e dokumentit është orientuar në një analizë të situatës aktuale të faktorëve që ndikojnë në zbatimin me sukses të amnistisë fiskale si: (i) politika fiskale dhe administrimi, (ii) shkalla e informalitetit, (iii) lufta ndaj korrupsionit dhe (iv) rreziku i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Gjithashtu dokumenti adreson rreziqet kryesore të zbatimit të projektligjit të hedhur për konsultim publik si dhe efektet e pritshme të tij. Dokumenti ka reflektuar vlerësimin e institucioneve financiare ndërkombëtare, si dhe të partnerëve për këtë projektligj. Dhe së fundmi janë reflektuar rekomandimet e nevojshme për alternativat për ndryshimet që gjykohet t'i bëhen projektligjit.

Amnistitë fiskale në Shqipëri

Mbas vitit 2010, janë ndërmarrë dy amnisti, përkatësisht në vitin 2011 dhe në vitin 2017. Ligji për Amnistinë Fiskale i vitit 2011 parashikonte shfuqizimin e një pjese të borxheve tatimore, doganore dhe detyrimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, duke vendosur parimet, garancitë dhe veprimet e subjekteve që rrjedhin nga legalizimi. Amnistia e dytë u zbatua në vitin 2017 dhe përfshinte individë, biznese, persona juridikë, shoqëri, për fshirjen pjesërisht ose plotësisht të detyrimeve tatimore dhe doganore, si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes së detyrimeve tatimore. Nuk përfituan subjektet që kishin detyrime të cilët ishin dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale në fushën tatimore dhe doganore, në kuptim të legjislacionit të fushës.

Në fakt, ligji i fundit i faljes fiskale të vitit 2017, megjithëse më i zgjeruar, ishte një vijimësi e ligjeve të qeverive të mëparshme që nuk sollti një përmirësim të treguesve të informalitetit dhe të evazionit fiskal. Të dyja amnistitë treguan probleme që lidhen me kohën e pamjaftueshme të diskutimit me të gjithë aktorët potencialë, si dhe e fushatës së pamjaftueshme për informim dhe ndërgjegjësim, mangësitë e legjislacionit të miratuar, rreziku moral i amnistisë. Zbatimi i saj mbeti jo i plotë.

Qëllimi i projektligjit të propozuar

Amnistia fiskale duhet të nënkuptojë amnistinë e përfitimit të padeklaruar në kuptimin e të ardhurave të padeklaruar në administratën tatimore, por jo edhe të fitimeve të cilat vijnë nga aktivitete kriminale si mbjellja dhe trafikimi i kanabisit, trafikimi i drogave të tjera, prostitucioni, korrupsioni etj. Projektligji krijon premisat për një amnisti fiskale dhe penale me një afat 1-vjeçar, për subjektet të cilat, në kushtet e procedurave të parashikuara në të dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, deklarojnë vullnetarisht pasuritë, me qëllim të ligjësimit të tyre dhe të formalizimit të aktiviteteve të krijuara gjatë 30 viteve të fundit.

Projektligji nënkupton: (i) garantimin e procedurave transparente për të mundësuar ligjësimin e pasurive të padeklaruar dhe/ose të paregjistruara, tërësisht apo pjesërisht, si dhe për rivlerësimin e pasqyrave financiare të subjekteve, (ii) parashikimin e procedurave të deklarimit dhe pagesës së detyrimeve tatimore për të ardhurat dhe pasuritë që deklarohen, (iii) përcaktimin e tarifave tatimore që do aplikohen dhe të afateve të deklarimit, (iv) ruajtjen e sekretit dhe të informacioneve që lidhen me këto pasuri, (v) mosfillimin e procedurave administrative e të procedimeve penale ndaj këtyre subjekteve nga ana e institucioneve përkatëse, në lidhje me këto pasuri.



Situata aktuale në të cilën përgatitet projektligji i amnistisë

Paligjshmëria e deklaramit në kushtet e vendit tonë është ndikuar nga një sërë faktorësh si mungesa e besimit tek institucionet publike, përfshi dhe administratën tatimore, të cilat shpesh konsiderohen si joefikase dhe të korruptuara; kufizimet në të bërit biznes; të drejtat pronësore që nuk mund të garantohen; mungesë funksionaliteti e sistemit gjyqësor në vend; probleme serioze me pronat, veçanërisht në lidhje me sigurinë juridike të tyre; fuqizimi jo adekuat i kornizës legjislative dhe rregullative; barra e lartë fiskale e kombinuar me shpenzime të larta administrative, furnizim i pamjaftueshëm i shërbimeve publike dhe infrastrukturës; shkalla e ulët e zbulimit nga administrata e shmangieve tatimore. Por, ndër faktorët thelbësorë nga i cili do të varet suksesi i zbatimit të amnistisë fiskale dhe penale do të jetë analiza e sistemit aktual fiskal, analiza e shkallës së informalitetit, analiza e nivelit të korrupsionit, si dhe masat për të luftuar pastrimin e parave.

Sistemi fiskal aktual

Sistemi aktual i taksave është kompleks dhe i fragmentuar dhe ndryshimet e shpeshta ad hoc kanë dëmtuar stabilitetin, transparencën e sistemit si dhe kanë ngushtuar më tej bazën tatimore. Përrjashtimet dhe trajtimet preferenciale për grupe dhe sektorë të ndryshëm tatimpaguesish janë shtuar si përgjigje ndaj presioneve të grupeve lobuese. Performanca e dobët në realizimin e të ardhurave është rezultat i ngushtimit të bazës tatimore, vështirësive në administrim dhe mbledhjes joefikase.

Tatimi mbi të ardhurat personale me pragjet e shumta fragmenton bazën e tatimit mbi të ardhurat. Sistemi aktual ofron stimuj dhe mundësi për tatimpaguesit për të minimizuar ose shmangur pagesën, duke i lejuar individët të ulin detyrimin e tyre tatimor ose të shmangen duke ndryshuar mënyrën e tyre të angazhimit p.sh., si biznes apo punonjës i vetëpunësuar¹. Sistemi tatimor nuk është neutral ndërmjet formave të veprimtarisë së biznesit. Shume individë raportojnë më pak për të ardhurat e tyre. Informaliteti mund të inkurajohet gjithashtu për shkak se barra administrative për biznesin e vogël mbetet e lartë. Në taksimin indirekt, një gamë shumë e gjerë mallrash, shërbimesh dhe tatimpaguesish përjashtohen nga taksat indirekte si TVSH dhe akcizat apo trajtohen me tarifa të reduktuara, duke dëmtuar efikasitetin e mbledhjes. Sistemi i TVSH-së, së bashku me tatimet mbi të ardhurat dhe taksat e tjera, ofron shumë përfitime për grupe të caktuara tatimpaguesish që dëmtojnë efikasitetin dhe integritetin e sistemit tatimor.

Sistemi fiskal nuk është gjithëpërfshirës dhe i drejtë për të mbuluar të gjitha grupet e taksapaguesve dhe siguruar që të gjithë tatimpaguesit paguajnë një barrë të drejtë tatimore sipas aftësisë së tyre për të paguar. Shumë tatimpagues që kryejnë evazion ose shmangie tatimore gjykojnë që sistemi fiskal lejon një trajtim të pabarabartë tatimor, barrë tatimore dhe shpenzimeve administrative të larta, si dhe veprimet arbitrare të organeve tatimore. Shpesh herë biznesit i imponohet evazoni për shkak të situatës së informalitetit apo dhe legjislacionit².

Sistemi fiskal aktual ka krijuar shtrembërime dhe nxitje si për shmangie dhe evazion, duke krijuar kushte të favorshme për një kulturë informale dhe konkurrencë të tregut pa rregulla dhe pa kontroll.

¹ Qeveria ka ndërmarrë një nismë për forcimin e ligjit për tatimin mbi të ardhurat, që synon thjeshtimin, rritjen e efikasitetit dhe barazi më të madhe mes tatimpaguesve të cilët fitojnë lloje të ndryshme të ardhurash, por që akoma nuk është miratuar

² Në shumë raste biznesi i vogël nuk pranon të blej mall me faturë duke detyruar biznesin e madh të kryej shkelje



Shkalla e lartë e informalitetit si pranim i gjerë i sistemit

Në 30 vitet e fundit, në ekonominë shqiptare, shkalla e lartë e informalitetit ka dëmtuar zhvillimin e një ekonomie konkurruese dhe me rregulla të qarta. Ekonomia informale nënkupton shkeljen e ligjit në mënyrë të qëllimshme, e shoqëruar me shmangie dhe evazion fiskal. Informaliteti ka cenuar bazën e taksave dhe mobilizimin e të ardhurave. Informaliteti në Shqipëri shfaqet në forma të ndryshme dhe pothuajse në të gjitha aktivitetet ekonomike. Një faktor që inkurajon informalitetin është perceptimi i mungesës së barazisë në sistemin tatimor, barra e lartë fiskale dhe shpenzimet administrative. Një nga format kryesore me efekt negativ në performancën e mbledhjes së të ardhurave nga taksa e punës, mbetet informaliteti në tregun e punës. Të ardhurat nga taksimi i punës janë shumë më të ulta krahasuar me vendet e rajonit.

Nga të gjitha raportet ndërkombëtare, dhe në veçanti të Bankës Botërore, niveli i informalitetit si përqindje e punonjësve informal kundrejt numrit total të të punësuarve mbetet më i larti në rajon. Një tregues i informalitetit është numri i kontribuuesve të sigurimeve shoqërore në raport me numrin e të punësuarve gjithsej nga raportimet e ISSH dhe INSTAT. Numri i punonjësve që nuk kontribuojnë në skemën e kontributeve shoqërore dhe shëndetësore jo vetëm që është i lartë në mbi 38% të totalit të punësuarve në vitin 2020, por gjithashtu ky tregues është përkeqësuar në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019 dhe 2018.

Ndërkohë sipas raporteve të institucioneve ndërkombëtare, administrata tatimore ka kapacitet të kufizuar dhe nuk mund të krijojë një pamje të plotë të tatimpaguesve individual, sepse: e para jo të gjithë tatimpaguesve u kërkohet të paraqesin një deklaratë tatimore, dhe e dyta administrata tatimore nuk është në gjendje të mbledhë të dhëna nga palët e treta p.sh., bankat, regjistrat e pronave, etj. për të kryqëzuar dhe kryer kontrollin e informacionit.

Vlerësime të organizmave që monitorojnë nivelin e korrupsionit

Sipas indeksit të perceptimit të korrupsionit të publikuar në vitin 2022 nga International Transparency, Shqipëria renditet në vendin e 110 nga 180 vende gjithsej, duke u renditur si një nga vendet me nivelin më të lartë të korrupsionit. Një diferencë të theksuar Shqipëria ka me vendet e rajonit krahasuar me Kroacinë në vendin e 63, me Malin e Zi në vendin e 64, me Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut në vendin e 87 dhe Serbinë në vendin e 90. Indeksi i perceptimit të korrupsionit është përkeqësuar gjatë viteve. Krahasuar me pozicionin e saj në vitin 2016, Shqipëria në vitin 2021 është përkeqësuar me 27 vende. Indeksi i Transparency International këtë vit e pa reformën në drejtësi si një fillim në luftën kundër korrupsionit, por ekspertët thonë se vonesa në ngritjen e strukturave kyçe si Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Byroja Kombëtare e Hetimit kontribuan në vlerësimin e dobët.

Vlerësimet e organizmave që monitorojnë çështje të kontrollit financiar dhe çështje të monitorimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

Raportet ndërkombëtare nënvizojnë rëndësinë e ndërmarrjes së veprimeve vendimtare kundër pastrimit të parave në të gjitha stadet duke filluar nga hetimet proaktive, ndjekjes penale dhe dënimeve përfundimtare për korrupsion të niveli të lartë dhe konfiskim i asetëve kriminale. Raporti i Moneyval në Korrik 2018 nënvizonte se megjithëse Shqipëria ka bërë përparim, rreziqet mbeten të



larta. Sipas vlerësimit kombëtar të riskut, kërcënimi kryesor janë të ardhurat kriminale që rrjedhin nga trafikimi i lëndëve narkotike, krimet dhe evazioni në fushën tatimore e doganore, dhe korrupsioni.

Sipas raportit të Moneyval numri i hetimeve të rasteve të korrupsionit mund të jetë në rritje, por numri i dënimeve përfundimtare mbetet i ulët në të gjitha nivelet. Korrupsioni në gjyqësor ndikon negativisht në funksionimin normal të sistemit të drejtësisë, duke minuar besimin e publikut në sundimin e ligjit dhe mosndëshkimin e kriminelëve. Gjithashtu, grupet e krimit të organizuar me individë të përkatësisë etnike shqiptare janë aktive në shumë vende të Evropës, me lidhje me rajone të tjera burimi, tranziti dhe destinacioni. Ato fokusohen kryesisht në trafikun e drogës, trafikimin e qenieve njerëzore dhe krimet kundër pronës. Të ardhurat e krimit qarkullojnë dhe investohen në disa forma në Shqipëri, p.sh. nëpërmjet investimeve në pasuri të paluajtshme dhe shoqëri tregtare.

Në raportin e vitit 2021 Basel Institute On Governance vlerëson një rrezik të ri të pastrimit të parave: atë të përdorimit të aseteve virtuale si kriptovalutat për qëllime legjitime dhe të paligjshme. Natyra e tyre pa kufij dhe ekzistenca jashtë sistemit zyrtar financiar i bën këto transaksione një mundësi joshëse për kriminelët që të fshehin të ardhurat e korrupsionit dhe krimeve të tjera, që i shmangen taksave ose të financojnë terrorizmin. Sipas indeksit që mat rrezikun e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në juridiksionet në mbarë botën, Shqipëria renditet në vendet e para, respektivisht në vendin e 39 nga 110, duke u konsideruar si një vend me risk të konsiderueshëm.

Në raportin për pastrimin e parave të muajit Mars të vitit 2022 të Departamenti të Shtetit të SHBA, Byroja Ndërkombëtare e Narkotikëve dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit nënvizon se ndërsa Qeveria e Shqipërisë ka bërë progres në drejtim të pengimit të pastrimit të parave në vitin 2021, shumë më tepër mbetet për t'u bërë. Shqipëria mbetet e pambrojtur ndaj pastrimit të parave për shkak të korrupsionit, pranisë së rrjeteve të krimit të organizuar dhe boshllëqeve në legjislacion dhe mbikëqyrje. Shqipëria ka një ekonomi të madhe cash dhe një sektor informal, të ardhura të konsiderueshme të parave dhe investimeve nga jashtë. Trafikimi i narkotikëve dhe aktivitetet e tjera të krimit të organizuar janë burimet kryesore të fondeve të pastruara.

Ndërsa në raportin e muajit Prill 2022, MONEYVAL nënvizohet se Shqipëria nuk ka përmirësim të ndjeshëm në masat për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit në përputhje me rekomandimet e FATF. Ndër çështje të tjera, raporti shqyrtoi zbatimin e kërkesave të reja ndërkombëtare për asetet virtuale, duke përfshirë, kriptovalutat dhe ofruesit e këtyre aseteve.

Në Qershor të vitit 2022, FATF nënvizon se që nga Shkurti i vitit 2020, kur Shqipëria mori një angazhim politik të nivelit të lartë për të punuar me FATF dhe MONEYVAL për të forcuar efektivitetin e regjimit të saj të luftës kundër pastrimit të parave dhe luftës ndaj terrorizmit, ajo ka ndërmarrë hapa drejt përmirësimit. Por, vendi duhet të vazhdojë të punojë për të adresuar mangësitë e saj strategjike duke përfshirë: (i) sigurimin e një kuadri ligjor të përshtatshëm për shkeljet e detyrimeve të regjistrimit të kompanive dhe OJF-ve si dhe zbatimin e sanksioneve proporcionale dhe bindëse; dhe (ii) rritja e numrit të ndjekjeve penale për pastrimin e parave, veçanërisht në rastet që përfshijnë vepra penale të huaja. FATF e ***vendos Shqipërisë në listën e shteteve nën mbikëqyrje të shtuar për rrezikun e pastrimit të parave dhe kërkon që të vazhdojë të zbatojë planin e saj të veprimit për të adresuar mangësitë strategjike të lartpërmendura sa më shpejt që të jetë e mundur, pasi të gjitha afatet kanë skaduar.***

Në 8 Qershor 2022, MONEYVAL vlerëson se Shqipëria ka arritur përputhshmëri të plotë me shtatë nga 40, rekomandimet e FATF-së që përbëjnë standardin ndërkombëtar të luftës ndaj pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, por ka ende mangësi në zbatimin e 29 rekomandimeve ku është



gjetur “në masë të madhe në përputhje”. Vendi mbetet "pjesërisht në përputhje" me katër rekomandimet. Shqipëria do të mbetet përsëri nën ndjekjen e zgjeruar të MONEYVAL dhe pritet të raportojë mbi progresin për të forcuar zbatimin e masave të luftës ndaj pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit brenda dy viteve.

Impakti dhe efektet e zbatimit të ligjit

Amnistitë fiskale kanë synuar : (i) formalizim të ekonomisë së padeklaruar, (ii) rritjen e të ardhurave nga deklaratimet vullnetare, (iii) zgjerimin e bazës tatimore, si dhe (iv) fillimi i rrëgjimit të zbatimit më të rreptë të ligjit, (v) riatdhësimi i fondeve nga jashtë kryesisht nga emigrantët, që mundëson hyrjen e likuiditetit të ri shtesë brenda sistemit financiar dhe ekonomisë, (vi) njohja formale dhe garantimi i të drejtave pronësore dhe rritja e fondit të aktiveve të paluajtshme.

Impakti dhe efekti pozitiv i zbatimit të amnistisë

Efektet pozitive të amnistisë tatimore dhe penale duhen të merren me rezervë në kushtet e vendit tonë, sepse si eksperiencia e mëparshme dhe gjendja aktuale nuk përbën një garanci për formalizimin e ekonomisë, rritjen e të ardhurave, apo forcimin e disiplinës fiskale.

Rritja e të ardhurave shtesë për buxhetin e shtetit, si dhe rritja e performancës së të ardhurave tatimore në të ardhmen, duhet të merret me rezervë sepse:

- **“Rreziku moral”**, mund të ketë një ndikim negativ në rritjen e të ardhurave për arsye se : (i) tatimpaguesit e rregullt mund ta shohin amnistinë fiskale si një favor për shkelësit e taksave, duke rrezikuar kështu që dhe ata të tentojnë të shmangen për të paguar detyrimet fiskale në përputhje të plotë me kuadrin rregullator në fuqi, (ii) shpallja e amnistisë dhe përmasa e saj mund t’u tregojë tatimpaguesve se sa e dobët ka qenë administrata tatimore në arritjen e zbatimit ligjor në fushën fiskale, dhe se frika e tyre për të guxuar të kryejnë ndonjë evazion fiskal nuk është justifikuar, (iii) individë shpresojnë që më vonë mund të pasojnë amnisti të tjera ndaj mund të tentojnë të vazhdojnë të bëjnë evazion me mendimin se do të ketë amnisti të tjera në të ardhmen.
- Vështirësia për riatdhësim të fondet nga jashtë nga emigrantët e ndikuar nga skepticizmi i tyre për një sërë faktorësh, si zhvillimet politike dhe ekonomike në vend, veprimet arbitrare dhe burokratike të institucioneve publike, siguria e fondeve të riatdhësuar, garancia për ruajtjen e sekretit të informacionit dhe konfidencialitetit, etj.

Nxitja për deklaram vullnetar dhe si rrjedhim rritja e numrit të tatimpaguesve të inkurajuar nga amnistia e propozuar, duhet të merret me rezervë për arsye se përveç **“rrezikut moral”**, arsye të tjera mund të jenë:

- Pasiguria për të garantuar ruajtjen e sekretit dhe të informacioneve që lidhen me këto pasuri,
- Pasiguria për garancinë që nuk do të fillojnë procedurave administrative dhe penale ndaj deklaramit të këtyre subjekteve
- Pasiguria që lidhet me ndryshime të mundshme të legjislacionit dhe veprimeve arbitrare



- Projektligji nuk ka një parashikim lidhur me trajtimin e detyrimeve të tjera tatimore që mund të rrjedhin si rezultat i vetë-deklarimit të transaksioneve apo ri-deklarimit të aktiveve, dhe për rrjedhojë mund të gjenerojnë kosto shtesë

Përfitimi se amnistia tatimore siguron një sistem të ri tatimor, me vendosjen dhe zbatimin e një disipline fiskale më rigoroze, rritjen e zbulimit, uljes së kostos **dhe rritjes së performancës**, duhet të merret me rezervë sepse:

- Qeveria do të duhej të prezantonte se pari një raport për të vlerësuar se deri në çfarë përmase performanca e mbledhjes së të ardhurave vjen për shkak të administrimit jo efektiv apo të politikës tatimore jo gjithëpërfshirëse dhe të drejtë.
- Amnistia propozohet në një kohë kur Shqipëria nuk ka përfunduar reformën për të përmirësuar cilësinë dhe eficientësinë e sistemit fiskal, reformë që do të rriste kredibilitetin e munguar të saj.
- Administrata shqiptare ka limite në kapacitetet dhe infrastrukturë të nevojshme për të ndërmarrë zbatimin e këtij ligji gjithëpërfshirës
- Nëse objektivat kryesore të amnistisë fiskale nuk do të përmbushen kjo do të stimulojë pritshmëri për amnisti të tjera në të ardhmen duke rrezikuar pagesën e rregullt të detyrimeve fiskale pas amnistisë.

Impakti dhe efektet negative të zbatimit të amnistisë

Ligji nuk ka një ndikim pozitiv të mundshëm për klimën e biznesit. Amnistitë fiskale kanë rezultuar në shkelje të barazisë fiskale tatimpaguesve të rregullt në raport me ata të cilët kanë shkelur ligjin dhe kanë kryer evazion tatimor, ose veprimtari kriminale. Impakti negativ i amnistisë vjen nga fakti se qeveria kryen amnistinë tatimore me koston e taksapaguesve të ndershëm, duke formalizuar të ardhurat në shkelje të ligjeve fiskale si dhe ato me origjinë kriminale.

a. Përkeqësim i mundshëm i klimës së biznesit në vend, do të reflektohet si:

- Ndërsa subjekti i amnistuar që ka qenë i padeklaruar paguan vetëm një tatim të posaçëm me normë të reduktuar dhe lejohet edhe të investojë në tituj shtetërorë, subjektet e deklaruara për të cilët mund të kenë një detyrim të papaguar apo janë në një procedurë penale për evazion³ në fushën tatimore dhe doganore nuk përfitojnë asgjë nga amnistia
- Subjektet e amnistuara do të përjashtohen nga detyrimi i dhënies së informacionit, do të përjashtohen nga ndjekja e procedurave hetimore dhe ndjekje penale, ndërsa për subjektet e

³ Neni 116, parashikon se evazoni tatimor konsiderohet : (i) fshehja apo shmangia nga pagimi i detyrimeve tatimore nëpërmjet mosdorëzimit të dokumenteve ose mos deklarimit të të dhënave të nevojshme, (ii) dorëzimi i dokumenteve të falsifikuara apo deklaratave ose informacioneve të rreme që çojnë në përlllogaritjen e pasaktë të shumës së tatimit, taksës apo kontributit, (iii) fshehje të të ardhurave, me qëllim fshehjen apo shmangien nga pagimi i detyrimeve tatimore, tatimpaguesit, (iv) mosdeklarimi i punonjësve dhe fshehja e pagës nëse nga verifikimi dhe kontrolli në vendndodhjen e biznesit rezulton se tatimpaguesi nuk ka deklaruar në organin tatimor çdo të punësuar rishtazi, të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës, (v) tatimpaguesit, që mbajnë në ruajtje, përdorin ose transportojnë mallra të pashoqëruara me dokumente tatimore, (vi) personi, i cili ushtron veprimtari ekonomike tregtare i peregjistruar, (vii) tatimpaguesit e regjistruar me përgjegjësinë tatimore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, të cilët nuk janë të regjistruar për TVSH-në, etj.



rregullta por që kanë ndonjë shkelje tatimore nuk përfitojnë nga amnistia, dhe do të vazhdojnë të jenë në një proces hetimi, të vendosjes së penaliteteve apo dhe sekuestrimit të pasurisë;

- Pabarazia ndërmjet personave të amnistuar, që do të paguajë detyrimin me një shkallë tatimore të reduktuar në raport me shkallën tatimore të tatimpaguesve të rregullt

b. Dëmtim i konkurrencës së ndershme, për sa kohë që :

- Amnistia fiskale do të konsiderohet si një praktikë normale, e cila do të aplikohet herë pas here nga qeveritë, duke dekurajuar në këtë mënyrë respektin për drejtësi, duke motivuar evazionin fiskal, dhe promovuar konkurrencën e pandershme;
- Bizneset do të shprehin shqetësimin e tyre për konkurrencën e pandershme nga ata që deri më tani kanë mbajtur pasuritë e tyre jashtë sistemit;
- Subjektet e formalizuar janë të diferencuar krahasuar me ata të padeklaruar sepse në rast se një tatimpagues i deklaruar nuk paguan detyrimin tatimor në kohe⁴, administrata tatimore mund ta mbledhë detyrimin tatimor nëpërmjet konfiskimit të pasurisë së siguruar në favor të administratës tatimore⁵, në pronësi të tatimpaguesit, ndërsa tatimpaguesi informal që është shmangur deklarimit dhe ka shkelur ligjin i jepet mundësia të formalizojë pasurinë e tij pa asnjë penalizim;
- Nuk jepet asnjë garanci që pas amnistisë fiskale, i ashtuquajtur “viti zero”, sistemi do të sigurojë zbatimin e duhur të legjislacionit fiskal në mënyrë që praktikat e evazionit fiskal të ndalojnë.

c. Pastrimi parave dhe pasurive kriminale mbetet një rrezik i shtuar, për arsye se:

- Riatdhesimi i pasurive të krijuara nga burime të jashtëligjshme jashtë vendit do të rrisë rreziqet e mundshme të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit
- Zbatimi i projektligjit është një rrezik i shtuar për sa kohë përfshin amnistinë fiskale dhe penale
- Për sa kohë që subjektet përjashtohen nga detyrimi i dhënies së informacionit pranë institucioneve përkatëse në lidhje me kohën, mënyrën e krijimit, mbajtjen apo posedimin e pasurive të deklaruara në përputhje me parashikimet e këtij ligji, është e vështirë të garantohet nëse ato nuk rrjedhin nga veprimtari kriminale
- Projektligji nuk parashikon mekanizma se si administrata dhe institucioneve financiare do të ndërmarrin veprime të kontrollit të deklarimit në përputhje me masat e luftes të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

⁴ Ligjit nr 9920 “ Për procedurat tatimore ne Republikën e Shqipërisë”, përcakton se detyrim tatimor përfshin, një tatim te papaguar, kamat vonese ose gjobe. Ndërsa gjoba përfshin gjoba për dënime administrative, për mos pagim ne afat te detyrimit tatimor, për mos deklarimi ne afat, për mos njoftim te ndryshimi te pronësisë, për transferimin e çmimit.

⁵ Neni 93 i ligjit nr 9920 “ Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” Nëse tatimpaguesi nuk paguan detyrimin tatimor në datën e caktuar, në përputhje me nenin 89 të këtij ligji, për njoftimin dhe kërkesën për pagesë, administrata tatimore mund ta mbledhë detyrimin tatimor të papaguar nëpërmjet sekuestrimit, e më pas konfiskimit, të pasurisë së siguruar në favor të administratës tatimore, në pronësi të tatimpaguesit



- Projektligji inkurajon subjektet të sjellin pasuri të padeklaruar në vlera të konsiderueshme shumë herë më të mëdha se vlerë e një transaksioni parashikuar në ligjin për pastrimin e parave për të cilin kërkohet verifikim dhe hetim nga institucionet përkatëse⁶
- Institucionet e administratës publike janë të brishta përfshi dhe njësinë për vetë deklarim për të përballuar verifikimin e fluksit të deklarimeve vullnetare,
- Koha pesë ditore e verifikimit dhe për të mbyllur procesin e përcaktuar nëse subjekti është përfitues është minimale dhe nuk justifikon këtë nxitim të parashikuar në ligj
- Në projekt propozim nuk parashikohen mekanizma frenues të cilët synojnë eliminimin e rrezikut real për pastrim parash

Rreziku i amnistisë penale, qëndron në faktin se projektligji parashikon se legjitimohen të gjitha pasuritë, të hollat, sende të çmuara, etj, amnistohet dhe përjashtohet ndjekja penale pavarësisht nëse këto pasuri janë përfituar si rezultat i veprimeve penale. Përjashtim bëjnë vetëm veprat penale të cilat mbulohen nga ligji për organizatat kriminale dhe ato nga akti normativ për OFL, duke e lënë shumë të gjerë spektrin e veprave penale, pa e kufizuar vetëm në amnistinë fiskale që lidhet me mosdeklarimin e të ardhurave. Kjo shton më shumë rrezikun e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, neni përkatës për amnistinë

- d. **Rreziku i pasqyrave financiare të besueshme**, qëndron në faktin se pastrimi i pasqyrave financiare sipas këtij projektligji është lënë në vetë vlerësimin e subjekteve që përfitojnë nga ligji dhe administrata tatimore mund të mos ketë garanci nëse vetë vlerësimi është realizuar korrektësisht. Njëkohësisht, dhe vetë audituesit ligjor apo kontabilistët për shkak të mungesës së sigurisë mund të refuzojnë të lëshojnë opinion auditimi mbi pasqyrat financiare të vitit në të cilin subjekti zbaton këtë ligj.
- e. **Rreziku për të përfituar nga amnistia funksionarë të lartë politikë dhe publikë**, për pasuritë e krijuara në mënyrë të paligjshme, sepse sipas parashikimit të ligjit subjektet që kanë pasur detyrimin ligjor për deklarimin e pasurisë, në zbatim të Ligjit Nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, si dhe personat në përbërje të certifikatës familjare të tyre, por që nuk janë në funksione në datën 01.01.2022, janë përfitues të këtij ligji. Ndërsa sipas parashikimit të Ligjit nr 9049, kjo kategori personash konsiderohen “persona të ekspozuar politikisht” deri në 3 vite pas largimit nga funksioni
- f. **Rreziku i dëmtimit të bashkëpunimit me vendet partnere**, sepse projektligji shkon në kundërshtim me frymën dhe parashikimet e konventave dhe parimin e përgjithshëm të reciprocitetit dhe marrëveshjeve për luftën e pastrimit të parave dhe financimi të terrorizmit. Zbatimi i këtij ligji mbi shtetasit shqiptarë që nuk janë rezidentë tatimorë në Shqipëri dhe u mundësohet riatdhesimi i pasurive informale, burimi i të cilave janë vendet partnere, do të bjerë ndesh me marrëveshjet e Taksimit të Dyfishtë dhe Parandalimin e Evazionit Fiskal në Lidhje me Tatimin mbi të Ardhurat

⁶ Sipas projektligjit të amnistisë parashikohet që pasuria që deklarohet nuk duhet të kalojë vlerën prej 2 milion Euro, kur ndërkohë në ligjin për pastrimin e parave dhe financimit të terrorizmit për një transaksion në vlerën 1 milion lekë kërkohet kontroll dhe hetim i plotë nga institucionet përkatëse



Kontrasti i mundshëm i zbatimit të ligjit mbi amnistinë me ligjet aktuale brenda vendit, marrëveshjet ndërkombëtare dhe angazhimet e Qeverisë ndaj Organizmave Ndërkombëtare.

1. Përputhshmëria me kuadrin ligjor brenda vendit

Është e paqartë se si Ligji nr 9917 : “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, do të zbatohet në kontekstin e kësaj amnistie, sepse në thelb të ligjit qëndron identifikimi i çdo transaksioni të dyshimtë për pastrim parash dhe financim të terrorizmit dhe për vlera shumë herë më të vogla se kufiri i vendosur prej 2 Milion Euro. Identifikimi vështirësohet për faktin se : (i) subjektet nuk kanë detyrim të deklarojnë burimin e të ardhurave, (ii) dhe në momentin që subjekti përfitues pajiset me vërtetimin e përfundimit të procesit të deklarimit përjashtohet nga detyrimi i dhënies së informacionit, përjashtim nga ndjekja e procedurave hetimore , nga ndjekja penale dhe mosvënies së masës së sekuestros.

Është e paqartë se si Ligji Nr. 9049, datë 10.4.2003,: “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, do të zbatohet në kontekstin e kësaj amnistie, sepse subjektet që përfshihen në këtë ligj për deklarim do të jenë përfitues të amnistisë në qoftë se nuk janë në funksion në datën 01.01.2022, kur ndërkohë në bazë të Ligjit nr 9049 kjo kategori personash konsiderohet “persona të ekspozuar politikisht” deri në 3 vite pas largimit nga funksioni.

Është e paqartë se si Ligji Nr 9920 : “ Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, do të zbatohet në kontekstin e amnistisë, sepse në thelb të Ligjit nr 9920 qëndron, (i) fakti që nëse një tatimpagues nuk shlyen detyrimin tatimor (tatimin, kamatëvonesën apo gjobën) rrezikohet t’i sekuestrohet dhe më pas t’i konfiskohet pasuria në pronësi, ndërsa subjekti që amnistohet jo vetëm që përfiton pa u ndëshkuar, i përjashtuar nga ndjekja hetimore apo penale, por dhe i lejohet t’i investojë në tituj shtetërorë (ii) nëse subjekti që fsheh apo shmanget nga pagimi i detyrimeve tatimore, apo edhe shkelje të tjera si mos deklarimi apo fshehja e pagës, etj ka kryer evazion tatimor dhe dënohet me gjobë, duke mos përfituar nga amnistia, ndërsa subjekti që ka kryer evazion dhe në të gjitha format e mundshme përfiton nga amnistia.

2. Përputhshmëria me marrëveshjet ndërkombëtare

Është e paqartë se si Konventat për Shmangien e Taksimit të Dyfishtë dhe Parandalimin e Evazionit Fiskal në Lidhje me Tatimin mbi të Ardhurat, do të zbatohen në rastin e amnistisë, sepse subjekti që riatdheson pasurinë e tij do të amnistohet në Shqipëri për një pasuri burimi i së cilës është vendi i huaj. Ligji amnistion një subjekt që ka kryer evazion në një vend të huaj me të cilin Shqipëria ka marrëveshje për parandalimin e evazionit fiskal.

Është e paqartë se si Ligji nr 93: “Mbi Konventën Shumëpalëshe për Zbatimin e Masave që Lidhen me Marrëveshjet Tatimore për Parandalimin e Erozionit të Bazës dhe Transferimit të Fitimeve (BEPS)”, do të zbatohet në rastin e amnistisë, sepse duhet të sigurohet që vendi vepron në përputhje me marrëveshjen për sa i përket veprimeve të subjekteve që kryejnë evazion të bazës tatimore dhe



zhvendosjen e fitimeve në vendin ku kryhet amnistia, në dëm të vendit të origjinës së burimit të krijimit të të ardhurave.

Qëndrimi i institucioneve ndërkombëtare që monitorojnë reformat ekonomike, fiskale, dhe masat e marra për pastrimin e parave

Projektligji për amnisti fiskale është përgatitur fillimisht në vitin 2020, por që mbeti i pamiruar. Paraprakisht për këtë version, Fondi Monetar Ndërkombëtar në raportin e publikuar në Korrik të vitit 2020⁷, nënvizon se projektligji nuk mbështetet nga Departamenti i Çështjeve Fiskale i FMN dhe Bashkimi Europian, pasi nuk përputhej me praktikën e mirë ndërkombëtare për skemat e deklarimit vullnetar.

Gjithashtu, po në këtë vit, Komisioni i BE-së ka paralajmëruar qeverinë shqiptare për disa çështje që mund të lindin nga miratimi i projektligjit për amnistinë fiskale, duke rekomanduar që ai të rishqyrtohet përpara se të miratohet nga Kuvendi, ose të adresojë disa çështje nëse vendos që të vazhdojë në miratimin e tij për sa i përket fushës së veprimit të tij dhe rrezikut të pastrimit të parave. Në qëndrimin e Delegacionit Europian nënvizohet se objekti i kësaj amnistie fiskale dhe penale do të shkonte përtej asaj të legjislacionit të ngjashëm të zbatuar në vende të tjera, duke këshilluar një rishikim i fushëveprimit të ligjit, me qëllim që të synojë vetëm evazionin fiskal të kryer nga personat që mund të jenë në Shqipëri, të cilët nuk kanë deklaruar pjesërisht ose plotësisht të ardhurat/transaksionet përkatëse në lidhje me pasuritë e tyre.

Delegacioni, në vlerësimin e tij, nënvizon se mbetet e paqartë për bankat dhe Moneyval, se si do të zbatohet Ligji Kundër Pastrimit të Parave në kuadër të kësaj amnistie, dhe se Ligji Nr. 9917 “Për luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” duhet të përfshihet në listën e legjislacionit për të cilin nuk zbatohet amnistia. Gjithashtu, Shqipëria duhet të sigurojë që ajo të veprojë në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare BEPS1, legjislacionit kundër pastrimit të parave dhe rekomandimet e Moneyval. Në vazhdimësi, në misionin e fundit të FMN në maj të vitit 2022, ritheksohet këshilla kundër një amnistie të mundshme fiskale, duke pasur parasysh shqetësimet për ndikimin e saj në performancën tatimore, si dhe rreziqet që lidhen me pastrimin e parave dhe administrimin tatimor⁸.

Në takimin e 13-të të Nënkomitetit për Tregtinë, Industrinë, Doganat dhe Tatimet, ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë të Komisionit Europian, janë nënvizuar shqetësime serioze për draftin aktual të ligjit për amnistinë fiskale. Ai do të dobësonte kontrollet e Shqipërisë kundër pastrimit të parave, për më tepër që rezidentët jo tatimorë përfshirë shqiptarët që jetojnë në BE ose në Ballkanin Perëndimor përfshihen në objektin e tij dhe u kërkohet të importojnë para në dorë për të përfutur nga amnistia. Drafti aktual i ligjit ngre shqetësime serioze për Shtetet Anëtare të BE-së dhe partnerët e tjerë, si dhe është një rrezik thelbësor reputacioni për vendin

⁷IMF Country Report No. 22/124 ALBANIA TECHNICAL ASSISTANCE REPORT—ENHANCING TAX ADMINISTRATION CAPACITY DURING CHALLENGING TIMES

⁸ Deklaratë për shtyp më 19 maj 2022



Alternativa të tjera më të mira të mundshme në periudhën afatshkurtër

Nisma e ndërmarrë për një amnisti fiskale dhe penale do të duhej të ndërmerrej kur të jetë vlerësuar se shteti është në gjendje të vendosë kontroll mbi evazionin dhe shmangiet fiskale, të informalitetit, korrupsionit dhe luftën ndaj pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit në një masë të pranueshme. Një alternativë e mundshme e ligjit mbi amnistinë do të ishte miratimi i saj me disa ndryshime si :

- Fushë veprimi i amnistisë të jetë vetëm amnistia fiskale për rezidentë që banojnë në Shqipëri
- Amnistia të përfshijë dhe faljen apo fshirjen e detyrimeve për tatimpaguesit e rregullt
- Është një nevojë kritike për të shlyer borxhin e pa arkëtueshëm kur është jo ekonomike të ndiqet ose nuk mund të rikuperohet ligjërisht. Praktika e mirë ndërkombëtare është që fshirja e borxhit të jetë një veprim i vazhdueshëm pasi të merren të gjithë hapat e arsyeshëm për mbledhjen e borxheve. Sipas raportit të FMN⁹, një pjesë e konsiderueshme e stokut të borxheve tatimore nuk janë të arkëtueshme.
- Për të qenë i besueshëm dhe për të mos rrezikuar të humbasë besimin dhe pajtueshmërinë e tatimpaguesve, ligji i amnistisë fiskale duhet të plotësohet me udhëzime për rritjen e zbatimit të detyrimeve ndaj taksapaguesve që nuk janë në përputhje me ligjin
- Është e domosdoshme një konsensus politik për miratimin e ligjit dhe garancinë e qëndrueshmërisë të ligji gjatë zbatimit
- Drafti i ligjit për amnistinë duhet të ketë dakordësinë e partnerëve, dhe në veçanti të Bashkimit Europian dhe të Fondit Monetar Ndërkombëtar

Alternativa e mundshme në periudhën afatgjatë

Një alternativë tjetër më afatgjatë që mund të përfshinte amnistinë fiskale dhe penale do të varej nga ecuria e reformave të politikave dhe administrimit fiskal, të uljes së informalitetit, uljes së korrupsionit dhe masat për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, Një amnisti në një periudhë më afatgjatë, gjykojmë që do të duhej që :

- Në prani të informalitetit të lartë, sistemi tatimor duhet të bazohet në një numër relativisht të vogël taksash me një normë të vetme ose shumë të vogël tatimore mbi baza të gjera. Kjo do të lehtësonte vlerësimin dhe administrimin.
- Shqipëria do të duhet të përfundojë reformën në përputhje me Strategjinë Afat Mesëm e të Ardhurave për të përmirësuar cilësinë dhe eficientësinë e sistemit fiskal për të ndërtuar një politikë fiskale gjithëpërfshirëse dhe neutrale, si dhe një administratë fiskale profesionale, e cila do të bllokonte mundësitë për pastrim parash dhe korrupsion.
- Zbatimi i reformave të shënonte progres në uljen e informalitetit, të korrupsionit, dhe në parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

⁹ Janë rreth 96 546 tatim pagues jo aktive që përfaqësojnë rreth 68 për qind e detyrimeve tatimore. Gjithashtu, 70 për qind e totalit të inventarit të detyrimeve të prapambetura janë të vjetra mbi dy vjet. Ligji i Procedurave Tatimore parashikon autoritetin për të shlyer borxhin tatimor të paarkëtueshëm pasi të jenë marrë masat përkatëse përmbarimore. Deri më sot, asnjë borxh nuk është shlyer duke përdorur këtë dispozitë.



Rekomandime në këtë fazë konsultimi

- Përpara zbatimit të amnistisë është e rëndësishme të bëhet një vlerësim paraprak i gjendjes së sistemit fiskal për të evidentuar mangësitë e sistemit fiskal dhe duhet të trajnohet administrata tatimore përgjegjëse për zbatimin e saj
- Ligji duhet të ketë një kohë të nevojshme për informim dhe sensibilizim të të gjithë subjekteve të përfshira në këtë proces
- Projektligji do të duhet të kishte parashikime të llogaritjes së përfitimeve dhe pritshmërive të impaktit në ekonomi
- Projekt ligji duhet të ketë një vlerësim, për rreziqet në zbatimin e tij për sa i përket pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe rrezikun e trajtimit të pabarabartë ndemjet subjekteve
- Përfitues i këtij ligji për amnistinë të jenë dhe të gjitha subjektet për të cilët ka filluar procedura penale për evazion në fushën tatimore dhe doganore
- Ligji do të duhet të marrë në konsideratë detyrimet e Shqipërisë për shkëmbim informacioni dhe parandalimin e evazionit fiskal në marrëveshjet tatimore në fuqi me partnerët e huaj
- Ligji duhet të reflektojë dhe të përfshijë rekomandimet e partnerëve ndërkombëtarë, si Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Komisioni Evropian, të cilët janë shprehur qartë dhe specifikisht mbi rreziqet që drafti i amnistisë fiskale paraqet, veçanërisht në lidhje me hapësirat e krijuara për evazion fiskal, korrupsion apo pastrim parash.
- Ligji i Amnistisë Fiskale duhet të ishte paraprirë ose i shoqëruar me krijimin e skemave ligjore, të cilat garantojnë mbrojtjen e suksesit të deritanishëm si dhe avancimin e hapave të parashtruara nga MONEYVAL në lidhje me luftën kundër korrupsionit, evazionit fiskal dhe pastrimit të parave.
- Për vetë rëndësinë që ka amnistia fiskale, koha që do të kërkojë dhe garantimi i qëndrueshmërisë në zbatimin e saj, Njësia Përgjegjëse do të duhet të ketë vartësinë nga Këshilli i Ministrave



KONKLUZIONE

Projektligji mbi amnistinë fiskale dhe penale në formatin që është hedhur për konsultim publik nuk duhet të shkojë për miratim për sa kohë shteti nuk është në gjendje të vendosë kontroll mbi informalitetin, korrupsionin dhe masave ndaj luftës për pastrimin e parave dhe financimit të terrorizmit. Amnistia nuk garanton trajtimin e barabartë të tatimpaguesve dhe dëmton klimën e biznesit. Përkundrazi, ligji favorizon subjektet e ekspozuara ndaj krimit dhe subjekte që kanë ekspozim politik. Aplikimi i një amnistie do të duhet të respektojë mbrojtjen e interesit më të lartë publik; sigurinë juridike, dhe barazinë e palëve para ligjit. Sipas nenit 18 të Kushtetutës të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe trajtim të diferencuar mund të ketë vetëm mbi arsye të përligjur dhe objektive, ndërkohë që një nismë e tillë do të krijojë një trajtim të pabarabartë fiskale dhe penale. Amnistia duhet të jetë gjithëpërfshirëse dhe të sigurojë një trajtim të barabartë si për subjektet që janë përfitues sipas ligjit, por dhe për subjektet e formalizuar që mund të jenë në shkelje.

Zbatimi i ligjit në formën që është paraqitur për një amnisti fiskale dhe penale mbart një rrezik të lartë të pastrimit të parave të përfituara në rrugë kriminale dhe korruptive. Ligji nuk garanton mekanizma të kontrollit për marrjen e informacionit për ndjekjen, hetimin e deklarimeve vullnetare. Ligji do të lejojë amnistinë e parave kriminale, riatdhesimin e parave të cilat janë të padeklaruara në vendin e burimit, dhe të parave të përfituara në mënyrë korruptive nga funksionarë apo familjarë të tyre. Një rrezik i lartë mbetet perceptimi se veprimtaritë kriminale do të amnistohen duke sjelle si pasoje nxitjen e ekonomisë informale dhe krimin. Ligji nuk jep garancitë e domosdoshme që mbas vitit “zero” do të forcohet kuadri ligjor dhe rregullativ për të mos lejuar shmangiet dhe evazionin tatimor, formalizimin e ekonomisë, për të synuar që shkeljet e ardhshme do të ndëshkohen me ashpërsi

Ligji i amnistisë, siç diskutohet të propozohet, bart rreziqe të shumta, jo vetëm në deformimin e disa parimeve të mbrojtura nga Kushtetuta, por edhe rreziqe që lidhen me sistemin financiar të vendit, luftën ndaj pastrimit të parave, vlerësimit të Shqipërisë në kuadër të organizmave ndërkombëtarë ku Shqipëria është pjesë, e deri te cenimi i elementëve që lidhen me sigurinë kombëtare. Shqipëria ka detyrimin për përmbushjen e rekomandimeve të FATF-së dhe MONEYVAL, në kuadër të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, ndaj ky projektligj nuk shkon kah përmbushjes së këtyre rekomandimeve. Drafti aktual i ligjit ngre shqetësime serioze për shtetet anëtare të BE-së dhe do të dëmtojë reputacionin si dhe bashkëpunimin me vendet partnere.

Projektligji i amnistisë fiskale duhet të ndryshojë duke përcaktuar si subjekte përfituese të amnistisë të jenë subjektet deklarues rezident në Shqipëri dhe subjektet e deklaruara që kanë detyrime tatimore, të garantohet rreziku i amnistisë i të ardhurave të përfituara në mënyrë korruptive nga funksionarë dhe politikanë si dhe familjarët e tyre, fusha e veprimit të mbetet vetëm amnistia fiskale, si dhe të garantohen mekanizmat që deklarimet të kontrollohen në përputhje me ligjin mbi luftën për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.



Referenca

1. IMF Country Report No. 22/52, ALBANIA : TECHNICAL ASSISTANCE REPORT— TAX POLICY REFORM OPTIONS FOR THE MTRS, February 2022
2. IMF Country Report No. 22/124 : ALBANIA TECHNICAL ASSISTANCE REPORT— ENHANCING TAX ADMINISTRATION CAPACITY DURING CHALLENGING TIMES, April 2022
3. United States Department, Bureau of International Narcotics & Law Enforcement Affairs: Strategy Report, Money Laundering, March 2022
4. Transparency International : Examining State Capture: Undue Influence on Law-Making and the Judiciary in the Western Balkans and Turkey, 2020
5. Konventat per shmangien e taksimit te dyfishte dhe parandalimin e evazionit fiskal, ne lidhje me tatimin mni te ardhurat
6. World Bank Group & The Vienna Institute for Internationa Economic Studies: Western Balkans Labor Market Trends, 2019
7. Report Accompanying the Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions 2020 Communication on EU Enlargement Policy, Brussels
8. Misioni i FMN-së ne vizitën në Shqipëri, PR22/161, Maj 2022
9. Report Accompanying the document Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions 2021 Communication on EU Enlargement Policy, Strasbourg, 19.10.2021
10. Basel AML Index 2021: 10th Public Edition : Ranking money laundering and terrorist financing risks around the world, basel Institute of Governance, 2021
11. FATF, Best Practices Paper MANAGING THE ANTI-MONEY LAUNDERING AND COUNTER-TERRORIST FINANCING POLICY IMPLICATIONS OF VOLUNTARY TAX COMPLIANCE PROGRAMMES, October 2012
12. EU Delegation to Albania's assessment of the draft law on "Fiscal and Penal Amnesty for Subjects of Voluntary Declaration of Assets", 2020
13. Moneyval, 2022, Anti-money laundering and counter-terrorist financing measures Albania, *Third Enhanced Follow-up Report, May 2022*
14. LIGJ Nr. 93/2020 : PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS SHUMËPALËSHE (MLI) PËR ZBATIMIN E MASAVE QË LIDHEN ME MARRËVESHJET TATIMORE PËR PARANDALIMIN E EROZIONIT TË BAZËS DHE TRANSFERIMIT TË FITIMEVE (BEPS)
15. L I G J Nr. 9920, datë 19.5.2008 : PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË I NDRYSHUAR
16. LIGJ Nr.9917, datë 19.5.2008 : PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT
17. Committee of Experts on the Evaluation of Anti-money Laundering Measures and the Financing of Terrorism, MONEYVAL, ANNUALREPORT, 2021



18. Committee of Experts on the Evaluation of Anti-money Laundering Measures and the Financing of Terrorism (MONEYVAL Anti-money laundering and counter-terrorist financing measures, Albania , Fifth Round Mutual Evaluation Report , July 2018
19. The World Bank Group : Strengthening the Sustainability of Albania's Growth Model, Albania Country Economic Memorandum, 2021 International Bank for Reconstruction and Development
20. Udhëzim, Nr. 6, datë 10. 02. 2004: PER MARREVESHJET BILATERALE PER SHMAGJEN E TAKSIMIT TE DYFISHTE DHE PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL